

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Muri mbrojtës" kundër AfD-së në provë, sondazhet e nxjerrin partinë fituese me diferencë të thellë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/muri-mbrojtes-kunder-afd-se-ne-prove-sondazhet-e-nxjerrin-partine-fituese-m-i584298
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 13:06:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 13:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d2689871a111435820020fffd1425ef789d303a8cd45c624c86ee6e94268f197e
TEKSTI	86c061446ebdeb461b9eeb47afc18cd6cfa5ca4b0d90d1b71f5cf7f52dc09568
PAMJA	38217ddfc3b1beba88c9fa633a414e668d2004fc745834e2677540d393c0bb80

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7cfd82de6785fd0410029b8e11563b9fac70bc5161f26a1c6d9d47a9bbf887ed
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	475d518598164a6fca4ccfef21e2861f646caa940cdcee184ece19d66f24a93c
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmdKiUsbe1dzvDLxvAjpyRejoijFNmdMrnWrgD5SJRvybp



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7cfd82de6785fd0410029b8e11563b9fac70bc5161f26a1c6d9d47a9bbf887ed>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1e [Operacioni antidroge ne Sarande, "Boraqi" i shpetoi prangave per vite! Kush jane te arrestuarit e tjere me precedenteKuhzimet e GJKKO ndaj medias, reagon BE: Po e mon fundit](#)

“Muri mbrojtës” kundër AfD-së në provë, sondazhet e nxjerrin partinë fituese me diferencë të thellë



6 Shtator 2026, 15:55Bota TEMA



Partia e ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë (AfD) pritet të dalë forcë e parë në zgjedhjet shtetërore në Saksoni-Anhalt, me sondazhet e fundit që e rendisin në rreth 41% të votave.

Një rezultat i tillë mund të ketë pasoja të rëndësishme për politikën gjermane dhe të rrisë presionin mbi kancelarin Friedrich Merz.

Rreth 1.7 milionë qytetarë kanë të drejtë vote në këtë land të Gjermanisë lindore. Qendrat e votimit janë hapur në orën 08:00 dhe do të mbyllen në orën 18:00, ndërsa sondazhet e para pas mbylljes së tyre pritet të japin një panoramë të rezultatit.

Nëse AfD arrin shumicën absolute, ajo do të mund të formojë për herë të parë një qeveri shtetërore. Një zhvillim i tillë do të ishte historik për partinë dhe për politikën gjermane të pasluftës.

Sondazhi i fundit i transmetuesit publik ZDF e vendoste AfD-në në 41%, ndërsa CDU-ja e kancelarit Friedrich Merz në 23%.

Pas tyre renditeshin Die Linke me 11.5%, Social Demokratët me 8.5% dhe të Gjellbrit me 6%. Dy parti të tjera nuk arrinin pragun prej 5% të nevojshëm për të siguruar përfaqësim në parlamentin e landit.

AfD ka përfutur nga pakënaqësia për ekonominë, emigracionin dhe politikat e qeverisë qendrore. Megjithatë, edhe nëse partia fiton bindshëm, formimi i qeverisë mund të jetë i vështirë, pasi partitë kryesore gjermane kanë refuzuar kategorikisht të bashkëpunojnë me të.

CDU dhe partitë e tjera kryesore kanë ruajtur të ashtuquajturën “Brandmauer”, ose “mur mbrojtës”, që nënkupton refuzimin e koalicioneve me AfD-në.

Partia në Saksoni-Anhalt është klasifikuar si “ekstremiste e krahut të djathtë” nga autoriteti gjerman i inteligjencës së brendshme.

CDU, e cila aktualisht qeveris landin, shpreson të ndërtojë një koalicion me disa parti për të ruajtur pushtetin, pavarësisht diferencës së madhe me AfD-në në sondazhe.

Kandidati kryesor i AfD-së në zgjedhje është Ulrich Siegmund, 35 vjeç, i cili është bërë një figurë e njohur e partisë edhe përmes rrjeteve sociale, veçanërisht TikTok-ut.

Siegmund ka deklaruar se do të marrë drejtimin e landit vetëm nëse AfD siguron shumicën absolute dhe ka përjashtuar një koalicion me partitë e tjera.

Para qendrës së votimit, ai shprehu optimizëm për rezultatin dhe tha se shpresonte që partia të arrinte rreth 45% të votave.

Programi i tij përfshin politika më të ashpra ndaj emigracionit, përfshirë një ofensivë për “rimigrim” dhe dëbime. Ai ka premtuar gjithashtu ndalimin e flamujve të ylberit në shkolla, kufizimin e ndërtimit të parqeve të reja me erë dhe ndryshime simbolike në identitetin e landit.

Votimi në Saksoni-Anhalt shihet si një test i rëndësishëm për kancelarin Friedrich Merz dhe qeverinë e tij.

Merz është përballur me kritika për ecurinë e ekonomisë gjermane dhe për pamundësinë për të ulur ndjeshëm mbështetjen ndaj AfD-së.

Një fitore e thellë e së djathtës ekstreme do të shtonte presionin ndaj kancelarit, veçanërisht pasi AfD ka kaluar CDU-në edhe në disa sondazhe kombëtare dhe synon një rezultat të fortë në zgjedhjet federale të vitit 2029.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut](#)

14:45 Bota / 1 koment

["Rezik për një tjetër Irak ose Afganistan" - Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Trump e ka futur veten në një ngërç, SHBA duhet të ndryshojë strategji për ta fituar luftën](#)

14:35 Bota

["Dekolonizim" apo censurë? Qyteti rusishtfolës i Odesës përgatit kufizime të reja ndaj gjuhës ruse në art dhe kulturë](#)

13:35 Bota / 4 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.